


Plani i Rimëkëmbjes së Qeverisë, 10 përqind i Trustit: Pse kjo masë funksionon?

Analizë Politikash

11/2020



Plani i Rimëkëmbjes së Qeverisë, 10 përqind i Trustit: Pse kjo masë funksionon?

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Korrik 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



Mbështetur nga:

**Rockefeller
Brothers Fund**
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Analizë për ndikimin afat-mesëm e politikës tërheqjes së mjeteve nga Trusti	2
Kursimi, rezervat dhe ruajtja e vendeve të punës.....	4
Analizë e përfitimeve nga tërheqja e 10 përqind dhe rritja e kërkesës agregate.....	5
Përfundime dhe rekomandime	6

Hyrje

Plani i Rimëkëmbjes Ekonomike, i shumëpërfolur që nga fillimi i pandemisë COVID-19 në mars të këtij viti, është në fazën e konsultimit publik. Edhe para se të votohej, ka pasur shumë avokime rreth këtij plani, çfarë duhet të përmbajë dhe kë saktësisht duhet t'a mbështesë. Ky Plan i Rimëkëmbjes Ekonomike po parashihet të kushtoj rreth 1.2 miliardë euro. Një ndër masat, respektivisht masa 5 e Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike¹ që parashikon masa për stimulimin e kërkesës agregate, e ku më e përfolura prej që është publikuar plani është padyshim masa për tërheqjen e 10 përqind të mjeteve të kursyera nga kontributdhënësit në Fondin Kosovar për Kursime Pensionale, që tash e tutje do të i referohemi si Trusti Pensional. Pra, kontributdhënësit do të kenë mundësinë të tërheqin 10 përqind të vlerës së kursimeve të tyre në Trustin Pensional dhe këtë mundësi do të mund ta shfrytëzojnë për një periudhë 3 mujore. Analistë dhe ekonomistë janë të ndarë në mes të atyre që konsiderojnë që kjo masë do të rrezikonte stabilitetin e Trustit dhe nuk do të mund të arrinte ndonjë rezultat tek rimëkëmbja ekonomike dhe atyre që e vlerësojnë këtë masë si pozitive.

Edhe pse kjo masë ka tërhequr vëmendjen e diskursit publik rreth mundësisë së tërheqjen së 10 përqind të kursimeve të tyre, qytetarët ende nuk do të mund të përfitojnë nga kjo masë pa u bërë ndryshimet e nevojshme ligjore. Specifikisht, për të mundësuar realizimin e masës do të duhet të plotësohet-ndryshohet Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116.² Propozimi apo ndryshimi i legjislacionit sipas Rregullores së procedurës së Qeverisë kalon nëpër një proces i cili zgjat mbi 250 ditë në rrethana optimale. Periudha e pandemisë dhe efektet që i ka pasur në ekonominë e vendit i ka krijuar mundësi Qeverisë të procedoj në procedurë të përshpejtuar një draft ligj për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19³ që synon të adresoj planin e rimëkëmbjes, njëra nga nënmasat e masës 5 ku thuhet: “Kthimi i një përqindjeje të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional për kontributpaguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 3-mujore, e cila shumë kompensohet nga shteti brenda 5 viteve”⁴. Rimbursimi i kësaj nën-mase llogaritet në plan që të jetë në shumën 170 milion euro dhe në deklaratimet e Ministrisë së Financave është mohuar rimbursimi nga Buxheti i Kosovës për hirë të parandalimit të kompenzimit të kursimeve në mënyrë të pa-barabartë për qytetarët.⁵

Në këtë punim do të reflektohet ana pozitive dhe arsyeshmëria se pse pas së gjithash kjo masë mund të funksionojë dhe të arrihet efekti i saj në rimëkëmbjen ekonomike. Fillimisht, duhet të kemi parasysh disa faktorë rrethorë që janë shkaktuar si rezultat i pandemisë.

Analizë për ndikimin afat-mesëm e politikës tërheqjes së mjeteve nga Trusti

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës apo siç njihet me emrin me të cilin është themeluar në vitin 2001 Trusti Pensional Kosovës është mekanizëm i cili obligon të gjithë të punësuarit në

¹ Zyra e Kryeministrit (2020), Prezantimi i Masave të Pakos së Rimëkëmbjes, Prishtinë: ZKM, i qasshëm në <https://kryeministri-ks.net/kryeministri-hoti-prezanton-masat-e-pakos-se-rimekembjes/> (qasur në korrik, 2020)

² Republika e Kosovës, (2012), Ligji Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Prishtinë: GZRKS, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2815> (qasur në korrik, 2020)

³ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2020), Vendim Nr. 03/12, Prishtinë: ZKM, i qasshëm në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-12-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf> (qasur në korrik, 2020)

⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2020), Programi Qeverisës 2020-2023, Prishtinë: ZKM

⁵ “MF-ja po e shqyrton mënyrën e tërheqjes dhe kompensimit të 10% të mjeteve nga Trusti Pensional” <https://www.epokaere.com/mf-ja-po-e-shqyrton-menyren-e-terheqjes-dhe-kompensimit-te-10-te-mjeteve-nga-trusti-pensional/>

Kosovë që të kursejnë 10 përqind të pagës së tyre në baza mujore për t'u siguruar që qytetarët e Kosovës do të kenë mjete të mjaftueshme për një jetë të dinjitetshme pas pensionimit. Ky sistem modern e tejkalon sistemin Jugosllav që ka qenë sistem i quajtur gjenerata për gjeneratën, ku kontributet e punëtorëve aktiv kanë mbuluar pensionerët e kohës. Ligji aktual e ndalon tërheqjen e mjeteve nga trusti para moshës së pensionimit, e cila është e përcaktuar në 65 vjet.

Në fund të vitit 2019, Trusti ka menaxhuar me 1,966,956,583 euro në 669,973 llogari të përfituesve ku gadi gjysma janë llogari aktive.⁶ Që nga themelimi e deri në fund të vitit 2019 tërheqja kumulative e mjeteve nga Trusti kap shumën 203,403,895 euro. Gjatë vitit të kaluar, sipas raportit vjetor për vitin 2019, Trusti ka raportuar 43,286 llogari të reja dhe numri i kontribuuesve aktiv ka qenë 379,827. Në buletin për tremujorin e parë të vitit 2020 Trusti ka raportuar ulje të ndjeshme të kontribuuesve gjatë muajve shkurt dhe mars ku nga 384,582 llogari aktive në janar numri i llogarive aktive ka shënuar rënie në 275,102 në mars.⁷

Gjatë Tremujorit të dytë, të tretë dhe të kartërt kthimi në investim ka qenë rreth 1 përqind për secilin tremujor. Rritja më e lartë ka qenë 5.56 përqind në Tremujorin e parë.⁸ Për dallim performanca e Tremujorit të parë të vitit 2020 ka shënuar një humbje prej 4.66 përqind.⁹ Nëse shikojmë për së afërmi humbjet më të mëdha kanë ndodhur në muajt shkurt dhe mars 2020, si pasojë e reagimit të tregjeve botërore ndaj masave për parandalimin e shpërndarjes së Pandemisë Covid-19. Rjedhimisht edhe dita me humbjen më të madhe ka qenë 23 marsi 2020 ku çmimi i njësisë ka shkuar në 1.39 nga 1.53 euro sa ishte në 19 shkurt 2020. Gjatë javëve të para të muajit korrik 2020 çmimi i njësisë është rikuperuar në 1.50 euro.¹⁰

Kontribuimi mesatar mujor gjatë vitit 2019 për punëmarrësit ka qenë 44.38 euro, ndërsa për të vetëpunësuarit 33.96 euro. Mesatarja e ponderuar e kursimeve në Trust, do të mundësonte një pasqyrë edhe më të saktë të ndikimit të tërheqjes së mjeteve nga kontribuuesit. Qeveria synon që të mundësoj lejimin e tërheqjes së mjeteve nga kursimet në trust vetëm për personat nën moshën e pensionimit apo siç njihen me terminologjinë ligjore “pjesëmarrës”. Pra nëse bëjmë një kalkulim duke marr për bazë pjesëmarrësin punëmarrës mesatar me një kursim 12 vjeçar, shuma që do të mund të tërheq do të kapte vlerën mesatare 639 euro. Ndërsa për të njëjtin shembull pjesëmarrësi i vetëpunësuar mesatar do të mund të tërheqte vlerën 489 euro. Të vetëpunësuarit kanë propabilitet më të lartë që një pjesë të këtyre mjeteve t'i përdorin për investime në kapital të punës (working capital). Kontribuesi punëmarrës do të shfrytëzonte mjetet kryesisht për konsum. Kohët e krizës ekonomike mund të rezultojnë në krijimin e obligimeve për shumë individ andaj çdo shumë të mjeteve që mund ta tërheqin qytetarët mund të shkojnë në kthime të borxheve që kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia i ka krijuar.

Ndikimi do të jetë më i madh nëse shikohet edhe tek dallimet në kontribute në bazë të grupmoshave. Grupmosha nga 55 deri në 64 vite ka pasur historikisht kontribut mesatar më të

⁶ Trusti Pensional i Kosovës, (2020), Raporti Vjetor 2019, i qasshëm në http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2020/05/RaportVjetor2019_shq.pdf (qasur në korrik, 2020)

⁷ Trusti Pensional i Kosovës, (2020), Trustorja Nr. 49, e qasshme në http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2020/05/Trustorja_TM1_2020.pdf (qasur në korrik, 2020)

⁸ Trusti Pensional i Kosovës, (2019), Trustorja Nr. 45, e qasshme në http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2019/05/Trustorja_TM1_2019.pdf (qasur në korrik, 2020)

⁹ Trusti Pensional i Kosovës, (2020), Trustorja Nr. 49, e qasshme në http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2020/05/Trustorja_TM1_2020.pdf (qasur në korrik, 2020)

¹⁰ Trusti Pensional i Kosovës, (2020), Çmimi i njësisë së FKPK-së, i qasshëm në http://www.trusti.org/sq/investimet/cmimi-i-njesise/?data_year=2020 (qasur në korrik, 2020)

lartë se grupmoshat tjera tek pjesëmarrësit punëmarrës. Probabiliteti është më i lartë se grupmosha 55-64 ka kontribuar më gjatë në skemën që ka filluar nga viti 2002 dhe një pjesë e tyre janë pjesë e skemës që nga fund-vitet e 30 deri tek mesi i viteve 40 të jetës së tyre. Në anën tjetër mosha e tyre e shtyrë do të ndikonte shumë rrezikimin e pensionit minimal që merret si indikator në raportin e Trustit. Për dallim kontributi tek të vetëpunësuarit është shumë më i ulët siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme.

	2019		2018		2017	
	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
15-24	€28.81	€20.82	€28.54	€21.18	€26.58	€20.45
25-34	€41.00	€25.82	€40.63	€26.04	€38.57	€26.52
35-44	€51.09	€35.37	€50.83	€35.45	€48.15	€34.97
45-54	€51.30	€37.16	€50.80	€37.15	€48.02	€37.32
55-64	€57.02	€39.40	€56.42	€38.52	€53.45	€37.77
65+	€64.32	€36.43	€60.35	€41.83	€58.03	€37.85

Kategoria që ka nevojë për stimulim duke marrë parasysh trendin e migrimit janë të rinjtë. I riu mesatar punëmarrës në rastet kur i ka 3 vite pune, do të mund të tërheq 103.7 euro nga kursimet. Në rast se shikojmë përbërjen gjinore, gruaja mesatare punëmarrëse do të mund të tërheq nga kursimet e veta 12.6 përqind më pak se një burrë mesatar punëmarrës. Ndërsa gruaja mesatare e vetëpunësuar 25.5 përqind më pak se një burrë i vetëpunësuar.

VITI	FEMRA		MESHKUJ	
	PUNËMARRËSE	TË VETËPUNËSUARA	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
2017	€37.35	€26.17	€41.29	€35.02
2018	€41.39	€26.22	€46.65	€35.50
2019	€40.59	€26.53	€46.47	€35.63

Pra nga një analizë shumë e thjeshtë mund të shihet se përfitimet do të jenë të ndryshme për 669,973 përfituesit e mundshëm dhe sjellja e tyre nuk mund të parashihet saktësisht. Mirëpo domodoshmërisht shpërndarja e gjërë e mjeteve do të ketë efekt pozitiv dhe zingjiror në ekonomi.

Kursimi, rezervat dhe ruajtja e vendeve të punës

Kur më 13 mars u raportua personi i parë me COVID-19 në Kosovë u shkaktua një panik në publik që rezultoi me dyndje të njerëzve në markete për të mbushur rezervat ushqimore si dhe për të u furnizuar sa më shumë me miell. Kjo pastaj vazhdoi të krijojë një frikë tjetër të përhapjes se

do të kemi mungesë mielli e që pastaj u vijua me mbushje të rezervave shtetërore me miell. Gjatë kësaj periudhe njerëzit poashtu tentojnë të kursejnë sa më shumë dhe të mos bëjnë shpenzime duke rezultuar në dëmtime të disa sektorëve. Këtu mund të hyjnë sektori i shitjes me pakicë, mobilieve, ndërtimtarisë etj.

Gjithashtu, një ndër dëmet më të mëdha të pandemisë padyshim që do të jetë humbja masive e vendeve të punës. Sipas të dhënave nga zbatimi i masës 8 të Pakos Emergjente Fiskale¹¹, masë kjo e dedikuar për punëtorët që kanë humbur punën si rezultat i pandemisë, rreth 1000 persona kanë humbur punën brenda 3 muajve. Si dhe në anën tjetër janë më shumë se 25 mijë familje që nuk asnjë të ardhur si rezultat i pandemisë e që janë paraqitur për masën 15 të Pakos Emergjente Fiskale¹² si dhe të njëjtat familje nuk janë pjesë e ndonjë skeme sociale. Kjo do të thotë që shumica e anëtarëve të këtyre familjeve kanë humbur punën si rezultat i pandemisë ose kanë pasur punë e cila ka qenë e bazuar në të hyra ditore siç është puna në treg. Ruajtja e vendeve të punës do të jetë një ndër sfidat më të mëdha të rimëkëmbjes ekonomike dhe e cila do të duhet të mirret parasysh sa më seriozisht nga ana e shtetit.

Analizë e përfitimeve nga tërheqja e 10 përqind dhe rritja e kërkesës agregate

Mundësia e tërheqjes së 10 përqind të kursimeve nga kontributdhënësit do të ndihmojë në rritjen e kërkesës agregate duke rritur konsumin, sektorin e shërbimeve, dhe në disa raste edhe ndërtimtarinë. Duke rritur kërkesën agregate shteti do të përfitojë nga Tatimi në Vlerën e shtuar si përfitim direkt. Ndërsa, përfitimi indirekt do të jetë shumë më i madh pasi që do të ndikojë në ruajtjen e vendeve të punës i cili rrezikohet të dëmtohet shumë nëse pandemia do të vazhdojë në këtë trend.

Pasi që kontributet e trustit taten me tatimin në të ardhura personale, Qeveria ka vendosur t'i propozoj Kuvendit që 10 përqind-shi i tërhequr të përjashtohet nga tatimi për të ardhurat personale. Edhe pse kjo në shikim të parë mund të konsiderohet si humbje për buxhetin e shtetit, nëse shikojmë statistikën e kontributdhënësve tregojnë të kundërtën. Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të ardhura personale¹³, respektivisht neni 6, pika 1.1 thotë që tatimi në të ardhura personale vjetore ngarkohet sipas shkallëve:

“1.1 Për të ardhurat e tatueshme nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) ose më pak, zero për qind (0%)”

Sa i përket kontributdhënësve, rreth 50 përqind e tyre kanë të kursime në trust deri në 1000 euro. Ndërsa, 90 përqind e tyre kanë kursime deri në 10,000 euro. Kjo do të thotë që rreth 90 përqind e kontributdhënësve nuk do të tatheshin me tatim në të ardhura personale. Nga kjo rezulton që pjesa tjetër e kontributdhënësve me kursime deri në 25,000 euro do të i ndihmonte buxhetit të shtetit me vetëm rreth 4,000,000 euro nëse ata do të tatheshin me tatim në të ardhura personale.¹⁴ Andaj edhe nëse modifikohet Draft Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-

¹¹ Zyra e Kryeministrit (2020), Vendimet e Qeverisë, Vendimet nga Mbledhja e 19-të e Qeverisë, i qasshëm në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>, (qasur në korrik, 2020)

¹² ibid.

¹³ Republika e Kosovës, (2015), Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014> (qasur në korrik, 2020)

¹⁴ Kalkulim nga INDEP bazuar në strukturën e të hyrave në Kosovë.

19 për të tatuar tërheqjet mbi 3000 euro, do të ulej ndikimi në buxhet për gjysmën e vlerës. Në të njëjtën kohë për kursimet nën 1000 euro, duhet të mundësohet tërheqje deri në 15% të shumës, për të ndikuar në mënyrë të gjerë që do të shkaktonte ngritje të ndjeshme të konsumit. Këto dy ndryshime në implementim të masës do të siguronin tërheqje më të ultë të mjeteve për kontribuesit më të mëdhenj të cilët sipas probabilitetit duhet të jenë më afër pensionimit dhe mjete të mjaftueshme për kontribuesit që kanë më pak mjete të kursyera e të cilët janë shumica dërmuese në moshë të re.

Marrë parasysh se gjendja nga fundi i vitit 2019 ka ndryshuar dhe tani janë mbi 2 miliard euro në Trust, tërheqja e plotë e mjeteve do të rezultonte në 200 milion euro në qarkullim në ekonomi. Nëse shikohet në përqindje të Produktit Bruto të Brendshëm do të kemi një ndikim afër 3 përqind e cila ndikon në stimulim të kryesisht të kërkesës agregate që do të ketë efekt multiplikues në vend i cili do të ketë një efekt zingjiror edhe në investime që do të ndikonte pozitivisht ekonominë edhe në vitin 2021.

Nëse llogarisim se dhjetë përqind e kontributdhënësve që do të mund të tërheqin mbi 1000 euro, mund të supozojmë që këto mjete do të ndikojnë më shumë pjesën e investimeve. Përderisa është e vështirë të parashikojmë sjelljen e akterëve në ekonomi, mund të bëjmë disa parashikime që bazohen në supozim të sjelljes. Nëse i marrim afër 40 përqind e mjeteve, pra rreth 75-80 milion euro, që mund të tërhiqen do të jenë në shumën mbi 1000 euro e nëse llogaritet që gjysma e këtyre mjeteve të përdoret në investime apo afër 0.5 përqind e Bruto Produktit Vendor.

Përfundime dhe rekomandime

Efektet afatshkurtër dhe afatmesëm do të ketë ndikim pozitiv në ekonomi në çfarëdo mënyre që i përdorin mjetet qytetarët, përfshirë kthimin e borxhit apo kredisë në institucione financiare. Posaçërisht që mbi 600 mijë përfitues do të kenë mundësi të tërheqin mjetet e tyre dhe të i shpenzojnë sipas nevojave që i kanë. Mirëpo, nëse kjo krizë duhet përdorur si momentum për të mundësuar një kërcim dhe adaptim të ekonomisë, efekt më të lartë do të kishte një shoqërim i kësaj mase me një tërheqje të mjeteve nga Qeveria për kategori të caktuara si rinia dhe gratë.

Duhet të rishikohet vlera e propozuar prej 10% në formën e tanishme. Duke pasur parasysh që paragrafi 2 i nenit 12A ka paraparë aplikim elektronik të pjesëmarrësve për tërheqjen e mjeteve, me akt nënligjor do të mund të rregullohej në atë mënyrë që qytetarët, me rastin e aplikimit të mund të zgjedhnin nëse duan të tërheqin 5%, 10% apo 15% të shumës së Trustit. Trusti pensional është fond individual i qytetarëve dhe atyre duhet t'u lihet të zgjedhin jo vetëm se a duan të tërheqin mjete nga fondi apo jo, por të paktën edhe një sistem tre-shkallësh ku ata do të mund të zgjedhnin edhe se sa para duan të tërheqin. Në këtë mënyrë, potencialisht do të mund të kishte më shumë mjete në treg dhe siguria e fondit nuk do të vihej në pikëpyetje.

Një element tjetër që duhet të rishikohet është edhe niveli i tatimit të pjesës që tërhiqet nga Trusti. Në draftligjin aktual të Qeverisë të gjitha shumat që tërhiqen janë të lira nga tatimi. Megjithatë, jo të gjithë qytetarët kanë arritur të mbledhin shumën të konsiderueshme në Trustin Pensional. Duhet konsideruar që shumat që tërhiqen mbi 5000 euro të jenë të tatueshme në bazë të Ligjit dhe që këto mjete të shkojnë në Buxhetin e Kosovës. Për këta qytetarë kjo nuk përbën një barrë të madhe dhe për shtetin janë të ardhura shtesë të cilat mund t'i fusë në ekonomi për të përkrahur grupet më të cenueshme nga pandemia.

Trusti në raportin vjetor të saj përfshin gjithnjë një rubrikë "Sa duhet Kursyer", ku mundohet të udhëzoj dhe demonstroj rëndësinë e kursimit për një pension të dinjitetshëm. Efektet afatgjatë do

të ndikoj në zvogëlim të kursimeve, që do ta dobësoj më tutje profilin “pensionit minimal.” Mirëpo, për të zbutur këtë ndikim afatgjatë Qeveria mund të vendos që të kompenzoj shumat deri në 500 euro të cilat janë tërhequr nga pjesëmarrësit. Gratë edhe më tutje kanë pjesëmarrje shumë të ultë në tregun e punës. Mbulimi i pjesës së mjeteve që tërhiqen nga gratë do të ishte edhe një stimulim për gratë që punojnë edhe një mesazh i shkëlqyer se kjo pako merr parasysh edhe pabarazitë shoqërore që ekzistojnë dhe kontribuon në zbutjen e këtyre pabarazive. Gjithashtu, duke qenë se pjesëmarrja e grave në ekonomi është në nivel jo të kënaqshëm, konsiderojmë që as kjo masë nuk do të ishte e papërballueshme për Qeverinë.

Një rekomandim tjetër që do të mund të përjashtohen pjesëmarrësit të cilët janë në dy vitet e fundit të kontribimit në skemë. Ky modifikim i Draft Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19 do të parandalonte shumë kontribues të cilët janë para pensionit e që nuk kanë kursime të mëdha të tërheqin mjetet, e gjatë pensionit të mbesin pa pensionin e Trustit.